

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 833 Prot.

Tiranë, më 19.062017

**VENDIM Nr. 140, datë 05.06.2017**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), VKM Nr. 280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave të dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi në ndërtimet me leje", Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.9, të datës 05.06.2017, pasi shqyrtoi Kërkesën e ALUIZNI-it Sarandë, për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit 1 kat të Z. Anastas Jorgji Mëhilli, Lagjia Nr. 3, i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Sarandës,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Kërkesën e ALUIZNI-it Sarandë, për konfirmim nga KKA, për vijimin e procedurës së legalizimit të objektit 1 kat të Z. Anastas Jorgji Mëhilli, Lagjia Nr. 3, i cili pozicionohet brenda zonës arkeologjike "B" të qytetit të Sarandës.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARDI FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**